



Republika e Kosovës  
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit  
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 896/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 40 (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008), Statutin e Komunës neni 6 nënparagrafi (b), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15, shkresës përcjellëse me numër 01/Nr. 114/2012 të datës 06.01.2012 nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit me numër 11-Nr.69/2012 të datës 06.01.2012, kërkesën e palës me numër 11/896, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 23.02.2012 mori:

## V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR SHFRYTZIMIN E PARCELËS Nr. 695-0 PËR HAPJEN E NJË MINIFERME

I

I jepet pëlqimi i përkohshëm „Agrobiznesi” SH.P.K për shfrytëzimin e një pjese të parcelës me numër Nr. 695-0, në zonën kadastrale Seçishtë në pronësi shoqërore e Ekonomisë Pyjore e evidentuar në fletën poseduese Nr. 1443/11, e cila do të shfrytëzohet për hapjen e një miniferme për kultivimin e dhive.

II

Vendimin ndaj kërkesës së parashtruar e jep Agjensioni i Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është pronë pyjore.

III

Pala obligohet në afat ligjor ( brenda dy viteve) që ti filloj punimet në të kundërtën do të shfuqizohet pëlqimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës.

IV

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi me numër 01/Nr.114/2012 i datës 30.01.2012, i cili ka qenë në emër të palës dhe i njëjti pëlqim kalon në emër të „Agrobiznesi” SH.P.K.

V

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

VII

Më këtë Vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit:  
Data: 24.01.2012

Kryesuesi i Kuvendit  
Menduh Vlasi

